



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

**Kuvendi i Komunës Istog**  
Skupština Opštine Istok  
Municipal Assembly Istog

Komititeti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

6	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	11.09.2018, në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
<b>Prosesmbajtës:</b>	Vjosa Hysenaj, Zyrtare për punë të Kuvendit të Komunës.
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Haki Podrimaj, Besa Ferati, Zenel Shatri, Eliot Kukiqi, Ardit Idrizaj, Ajshe Metaj.
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjera:</b>	Nënkyetari Lulzim Blakaj, Hazbi Bajra, Hysni Maxharaj, Isa Hoxha, Hazbi Bajra, Fitim Nuhiu dhe Hysena Pelaj OSBE, Lulzim Shoshi, Enver Rugova, Jeta Balaj,

#### Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2019-2021.
3. Marrja e Vendimit për dhenjen në shfrytëzim me ankand publik për zhvillim ekonomik.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt- Rregullores për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore.

#### Diskutimet:

**Kryesuesi – z. Qaush Balaj** - përshëndet Nënkyetarin z. Lulzim Blakaj, anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtoret, Zyrtar të Administratës Komunale, përfaqësues të OSBE, KFORI, mirë se keni ardhur ju faleminderit për pjesëmarrje.

Duke pasur parasysh se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë e Financa është arritur me lejoni që të shpallë të hapura punimet e mbledhjes se Komitetit për Politikë e Financa. Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje.

**Nënkyetari i Komunës** – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon dy pikat të rendit të ditës: Shpallja qytetar nderit për z. Peter Benyer MDB, ku lexon biografin e tijë të bujshme, si dhe pikën tjetër Rialokimi dhe transferi i mjeteve të vitit 2018.

**Enver Rugova** – përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron transferin dhe rialokimin e

mjeteve buxhetori për vitin 2018.

Hedhe në votim Propozimin e Nënkryetarit transferin dhe rialokimin e mjeteve për vitin 2018, Miratohet unanim nga anëtaret e4 KPF-s.

Hedhe në votim Propozimin e dytë të Nënkryetarit transferin dhe rialokimin e mjeteve për vitin 2018,

Hedhe në votim dendin e ditës me këto dy pikat te propozuara nga Nenkryetari.

**Konstatojmë se rendi i ditës miratohet një zërit, pa vërejtje me propozimet e nenkryetarit.**

**Vendimet:**

**Miratohet rendi i ditës nga KPF-së pa vërejtje**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

### Shqyrtimi i pikës 1.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi**, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyete nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rreth procesverbalit.

Pasi që nuk partë diskutime

Procesverbali hidhet në miratim:

**Vendimet:**

**Miratohet Procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje,**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

### Shqyrtimi i pikës 2.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi** - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2019-2021.

**Hysni Maxharraj** – Drejtor për Buxhet dhe Financa, pëershëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Draft Buxhetit për vitin 2019-2021.

**Ardita Idrizaj, AAK** - pëershëndet të gjithë të pranishmit, propozon që të hy në projekt ndërtimi i rrugës në Lubozhdë lagja Idrizaj, për vitin 2019.

**Besa Ferati, LDK** - pëershëndetje për të gjithë, ndërtimi i rrugëve në Gurrakoc të emrohen rrugët cilat rrugë do të ndërtohen janë ndarë vetëm 50 mijë euro janë pak, ndërsa të ndërtimi i rrugëve në Istog janë 150 mijë, të hiqen 50 mijë dhe të shpërndahen në Gurrakoc 20 mijë në Banjë 20 mijë euro për ndërtimin e rrugëve dhe në Saradran 10 mijë euro.

**Isa Hoxha**, Drejtor i Urbanizmit – pëershëndet të gjithë të pranishmit, në fshatin Gurrakoc nuk ka mbetur rrugë të pa ndërtuara por vetëm rrugica.

**Besa Ferati, LDK** – çka ka ndodhur me tenderin për mbajtjen e turnirit për nderë të Fadil Feratit, tenderi është fituar ndërsa turniri ende nuk është mbajtur.

**Nënkyetari i Komunës** – nëse kontrata është bëre turniri duhet të mbahet. Ndërsa për mjetet në Gurrakoc me mirë është vetëm të jetë asfaltimi i rrugëve në përgjithësi se sa të ndahen me emra se janë rrugica të shkurtra. Ndërsa në Istog është zonë urbane dhe duhet asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, në Banjë me këto mjete që janë parapara janë të mjaftueshme për ato rrugë.

**Jashar Blakaj, Drejtor** – përshëndet të gjithë të pranishmit sqaron, për zonat urbane janë propozuar buxheti për tri vitet për Istog, Vrellë, Banjë dhe Gurrakoc, në Istog ka shumë rrugë të pa asfaltuara.

**Haki Podrimaj, LDK** – 100 mijë euro betonimi i kanalizimit në Prigodë? Ky projekt po përsëritet çka po ndodhë.

**Nënkyetari i Komunës** – te ky kanal ka dështua një here punën kryerësi nuk i ka kryer punët me afat ka punuar vetëm për 20 mijë euro dhe ato mjete ja kemi dhen dhe tani duhet të dal në tender prapë.

**Haki Podrimaj, LDK** – në bujqësi 40 mijë euro për automjete vetura zyrtare pse?

**Nënkyetari i Komunës** – këtu është gabim teknik sepse tani nuk kemi të drejt të bëjmë blerjen e automjeteve zyrtare sepse do të jen përmes kompanive me tender.

**Haki Podrimaj, LDK** – Istogu ka krekës dhe nevojë për me shumë se 150 mijë euro, por edhe Banja sa janë të planifikuara 40 mijë euro janë pak, e përkrahi propozimin e koleges Besës që në Gurrakoc 20 mijë në Banjë 20 mijë euro për ndërtimin e rrugëve dhe në Saradran 10 mijë euro.

**Nënkyetari i Komunës** – në Istog me i hjek 20 mijë euro dhe me i qu 10 mijë në Banjë dhe 10 mijë në Gurrakoc.

**Eliot Kukiqi, AAK** – ndriçimi në Saradran nuk e pash në planifikim hiq.

**Zenel Shatri, LDK** – është shumë e nevojshme që të blihet një inserator për djegën e mbeturinave medicionale ato e ndotin shumë ambientin.

**Mujë Osmanaj, Drejtor i Shëndetësisë** – ne këto mbeturina i dërgojmë në Pejë për asgjësim kemi kontratë aty.

**Zenel Shatri, LDK** – spitali i Istogut nuk i dërgon mbeturinat në Pejë, sepse kontrata ka mbaruar, andaj kërkoj nga ju që të ndahen 15 mijë euro për inserator.

**Neënkyetari i Komunës** – në Drejtorin e Kulturës i kemi 40 mijë euro se do ti shpërndajmë

dhe: për ndriçimin për Saradran 10 mijë euro , 10 mijë asfaltimi i rrugëve në Gurrakoc dhe 20 mijë euro ndërtimi i rrugëve në Banjë.

**Ardita Idrizaj, AAK** – të mirëmbajtja e rrugëve malore 20 mijë euro të merren do për asfaltimin e rrugës në fshatin Lubozhd, dhe 10 mijë euro të merren nga asfaltimi i rrugëve në Cerrcë.

**Hysni Maxharraj**, Drejtor për Buxhet dhe Financa – 15 mijë euro mund ti marrim në rrugën “Rugova” në Cerrcë dhe në rrugën Hakaj 5 mijë euro po në Cerrcë.

**Ajshe Metaj, PDK** – kanalizimi në fshatin Kamenicë kur do të filloj dhe cila është kompania qe ka fituar tenderin.

**Enver Rugova**, Drejtor i Shërbimeve Publike – ende jemi në fazën e tenderimit nuk dihet kompania e cila do ta fitoj tenderin.

**Eliot Kukiqi, AAK** – të ndahen mjete për zyrën e veteranëve të luftës, për shpenzimet që ju duhen.

**Nënkyetari i Komunës** - komuna nuk ka të drejt të ndaj buxhet të posaçme për as një organizat, por ne mund të ju ndihmojmë në forma tjera.

**Zenel Shatri, LDK** – propozon që të hynë në projekt lumi Shushica në fshatrat Kovrag dhe Tomoc dhe kubëzimi i trotuarit.

**Ajshe Metaj, PDK** – shkolla e mesme në Istog të paiset biblioteka me lektyra dhe me tituj të ri shkencorë.

**Nënkyetari i Komunës** – 10 mijë euro për furnizimin e shkollave me literaturë.

**Zenel Shatri, LDK** – 10 mijë euro të ndahen në të gjitha shkollat të furnizohen të gjitha shkollat e fshatrave me literaturë, sepse shkollat neper fshatrat kanë nevojë ma shumë për literaturë se këtu në Istog kanë mundësi me të mëdha sepse është edhe biblioteka e qytateit aty ka tituj të ri biblioteka.

**Kryesuesi i Kuvendit** – propozon që të ndërtohet trotuari në fshatin Zallqë, Zabllaq dhe Rudicë është një rrezik shumë i madh aty kërkoj të gjindet një mundësi për këtë trotuar dhe për ndriçimin.

Problemi i lumbit Istog të gjithë e dini këtë problem e sidomos kush bie në rrugën e Zallqit në urë aty bëhet si kënetë dhe të gjitha ato shtëpi në afërsi i merr uji për çdo vjettë kërkoj që të pastrohet të paktën ajo pjesa aty tek ura.

**Kryesuesi** – pasi që diskutime tjera nuk ka: hedh në miratim miratohet me shumicë votash.  
**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejje dhe diskutime të tjera, KPF-ja vendosi:** të miratohet Draft Buxhetit për

vitin 2019-2021, dhe i njejtë i kalohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 3.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës. Marrja e Propozim - Vendimit për dhenjen në shfrytëzim me ankand publik për zhvillim ekonomik.

**Nënkryetari i Komunës** - prezanton dhe sqaron Propozim - Vendimit për dhenjen në shfrytëzim me ankand publik për zhvillim ekonomik.

**Kryesuesi** - pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** që të miratohet Propozim - Vendimit për dhenjen në shfrytëzim me ankand publik për zhvillim ekonomik, dhe e njëjta i kalohet kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 4.

**Diskutimet:**

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore,

**Hajrush Shoshi, Drejtor i Arsimit** – bene prezantimin dhe sqarimin e Projekt- Rregullores për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore,

**Ajshe Metaj, PDK** – propozon që në shkolla të ketë Pedagog, mjeket të janë në shkolla Stomatolog,

**Hajrush Shoshi, Drejtor i Arsimit** – e kemi një stomatolog në shkollën filliore Bajram Curri në Istog, jemi me një projekt që po mundohemi të i bëjmë mjekët neper shkolla.

**Ajshe Metaj , PDK** – shtëpiaku në shkollë çfarë detyre ka .

**Besa Ferati , LDK** – të kurset private ka profesor që mbajnë kurse private në objektin e shkollës dhe i kushtëzojnë nxënësit me shkua në kurs për një not ma të mirë.

**Zenel Shatri, LDK** – për shembull në shkollën filliore janë formuar tri klasë dhe janë katër mësuese cili duhet të mbetet pa or.

**Hajrush Shoshi, Drejtor i Arsimit** – do të bëhet testimi dhe vlerësimi i mësimdhënësve,

**Haki Podrimaj, LDK** – ju lutem që kjo rregullore të lekturohet për shkak se ka gabime të shumta.

**Kryesuesi** – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** që të miratoj një zëri Projekt-Rregullores për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore, dhe e njëjtë i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 5.****Diskutimet:**

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për shpalljen qytetar nderit z. **Peter Benyer MdB**,

**Nënkyetari i Komunës** -bene prezantimin dhe sqarimin e Propozim Vendimit për shpalljen qytetar nderit z. **Peter Benyer MdB**,

**Kryesuesi** - pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** që të miratoj një zëri Propozim Vendimit për shpalljen qytetar nderit z. **Peter Benyer MdB**, dhe e njëjtë i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 6.****Diskutimet:**

**Kryesuesi** - po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i për transferin dhe rialokimin e mjeteve për vitin 2018;

**Nënkyetari i Komunës** -bene prezantimin dhe sqarimin e për transferin dhe rialokimin e mjeteve për vitin 2018,

**Kryesuesi** - pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi:** që të miratoj një zëri Projekt-Rregullores për të drejtat, detyrat, përgjegjësinë disiplinore të punonjësve në institucionet Edukativo-Arsimore, dhe e njëjtë i kalon kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

**DISKUTIME**

**Kryesuesi** - para mbylljes së mbledhjes konstaton kuorumin prezentë ishin të gjithë anëtarë e

Komititeti për Politik e Financa, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë për këtë mbledhje.

Shpall të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

**Mbledhja përfundoj :** **13:40**